



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3023/18 / prot

Datë 25.07.2019

VENDIM

Nr. 126 datë 25/07/2019

**“PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË REGJISTRIMIT DHE SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË BACHELOR DHE NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË NË FUSHËN E DREJTËSISË, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020”**

Bazuar në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH” në nenin 3 pika 3 gërma ç), nenin 38 pikat 1 dhe 3, neni 49 pika 2 gërma c); VKM Nr. 288, datë 21.5.2018 “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”; Statutin e Universitetit të Tiranës neni 55, Vendimit të Senatit Akademik Nr.31 datë 18.07.2019, Bordi i Administrimit të Universitetit të Tiranës,

**VENDOSI:**

1. Tarifat e regjistrimit për programet e studimeve të ciklit të parë Bachelor dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë, për vitin akademik 2019-2020, të jenë si më poshtë:
  - Tarifa e regjistrimit në shumën 1600 lekë.
  - Tarifa e regjistrimit për programet e dyta të studimit në shumën 3000 lekë.
  - Tarifa e regjistrimit për transferimin e studimeve në shumën 3000 lekë.
2. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët që regjistrohen në vitin e parë të ciklit të parë Bachelor dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë për vitin akademik 2019-2020, do të jetë sipas tabelës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Studentët brenda kohëzgjatjes normale të programit të studimeve, i nënshtrohen vetëm një tarife vjetore shkollimi, atë të vitit përkatës.
4. Studentët në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor paguajnë tarifë shkollimi për tre vite akademike, të ndarë në vite (sa kohëzgjatja e programit mësimor). Studentët në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë paguajnë tarifë shkollimi për pesë vite akademike, të ndarë në vite (sa kohëzgjatja e programit mësimor).
5. Ngarkohet Administratori UT-së me strukturat përkatëse administrative pranë Rektoratit dhe në fakultete, të marrë masat e nevojshme për procedurat e mëtejshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi në buxhetin e vitit 2019 si dhe në PBA të e vitit 2020-2022.




Tabela 1

Tarifat e shkollimit në programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor" dhe në një program të integruar të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë, me kohë të plotë, për vitin akademik 2019-2020

Nr.	FAKULTETI/ FILIALI	Lloji i programit të studimit	Emërtimi i programit të studimit	Tarifa vjetore e shkollimit (në lekë)	Tarifa vjetore e shkollimit për program të dytë, (në lekë)
1	Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë	Bachelor	Histori	30,000	60,000
		Bachelor	Gjeografi	30,000	60,000
		Bachelor	Gjuhë- Letërsi	30,000	60,000
		Bachelor	Gazetari	30,000	60,000
		Bachelor	Arkeologji	30,000	60,000
2	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Bachelor	Biologji	25,000	203,690
		Bachelor	Bioteknologji	25,000	203,690
		Bachelor	Matematikë	25,000	203,690
		Bachelor	Fizikë	25,000	203,690
		Bachelor	Informatikë	25,000	203,690
		Bachelor	Kimi	25,000	203,690
		Bachelor	Kimi dhe Teknologji Ushqimore	25,000	203,690
		Bachelor	Kimi Industriale dhe Mjedisore	25,000	203,690
		Bachelor	Inxhinieri Matematike dhe	25,000	203,690
		Bachelor	Teknologji Informacioni	25,000	203,690
3	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	Bachelor	Gjuhë Angleze	25,000	135,730
		Bachelor	Gjuhë Frënge	25,000	135,730
		Bachelor	Gjuhë Gjermane	25,000	135,730
		Bachelor	Gjuhë Italiane	25,000	135,730
		Bachelor	Gjuhë Greke	25,000	135,730
		Bachelor	Gjuhë Turke	25,000	135,730
		Bachelor	Gjuhë Ruse	25,000	135,730
		Bachelor	Gjuhë Spanjolle	25,000	135,730
		Bachelor	Psikologji	40,000	111,778
		Bachelor	Punë sociale	40,000	111,778
4	Fakulteti i Shkencave Sociale	Bachelor	Filozofi	40,000	111,778
		Bachelor	Sociologji	40,000	111,778
		Bachelor	Shkenca Politike	40,000	111,778
		Bachelor	Administrim dhe Politika Sociale	40,000	111,778
5	Fakulteti i Ekonomisë	Bachelor	Administrim Biznes	35,000	86,374
		Bachelor	Ekonomiks	35,000	86,374
		Bachelor	Financë	35,000	86,374
		Bachelor	Informatikë Ekonomike	35,000	86,374
6	Fakulteti i Drejtësisë	Bachelor/Program i integruar	Drejtësi	40,000	63,000
7	Filiali i UT-së Sarandë	Bachelor	Administrim Biznes	35,000	86,374
		Bachelor	Gjuhë Angleze	25,000	135,730